



# **GJENDJA FINANCIARE DHE HUAMARRJA E FAMILJEVE NË SHQIPËRI**

**Gjashtëmuji i dytë 2019**

**BANKA E SHQIPËRISË  
DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR**

**Shkurt 2020**

## Përmbajtja

Përmbledhje e gjetjeve kryesore të vrojtimit mbi gjendjen financiare dhe huamarrjen e familjeve .....	3
Karakteristikat demografike dhe financiare të familjeve të intervistuar .....	4
Huamarrja e familjeve .....	6
Ngarkesa në borxh e familjeve .....	11
Pasuria e familjeve.....	13

## Përmbledhje e gjetjeve kryesore të Vrojtimit mbi Gjendjen Financiare dhe Huamarrjen e Familjeve

Vrojtimi i gjendjes financiare dhe huamarrjes së familjeve kryhet që prej vitit 2010, me frekuencë gjashtëmujore. Procesi i intervistimit u realizua në nëntor 2019, duke pasur në fokus zhvillimet në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2019 (maj-nëntor), ndërsa pritshmëritë i referohen gjysmës së parë të vitit 2020. Në këtë vrojtimit, u përfshi një kampion rastësor prej 1210 familjesh, të shtrira gjeografikisht në të gjithë vendin.

### ▪ GJENDJA FINANCIARE

Numri total i të punësuarve në kampionin e vrojtuar ka rënë krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë, dhe rënia ka ardhur nga të tre kategoritë e të punësuarve (sektor shtetëror, privat dhe të vetëpunësuar). Niveli i përgjithshëm i të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve *ka rënë gjatë periudhës së vrojtuar*, por rënia e shpenzimeve ka qenë më e theksuar, duke rezultuar në *një përmirësim të lehtë të balancës financiare* (të ardhura – shpenzime) të familjeve.

### ▪ HUAMARRJA

Rreth 24% e familjeve të përgjigjura (ose 257 familje) deklarojnë se *kanë hua për të paguar në momentin e intervistimit*, pavarësisht llojit, burimit apo vlerës së saj. Kjo peshë ka mbetur e pandryshuar krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe ka shënuar një rënie të lehtë (me 1.8 pp) krahasuar me një vit më parë, duke vijuar të mbetet nën mesataren historike të vrojtimit prej rreth 28% të familjeve. *Totali i tepricës së raportuar të huasë* ka rezultuar në rritje krahasuar me vrojtimin e kaluar dhe me një vit më parë. Rreth 73% e vlerës së huasë është siguruar nga *burime formale* dhe 27% nga *burime joformale*. Kjo strukturë është zhvendosur me 3 pp në favor të huamarrjes nga burime formale krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë. Kjo ka ardhur si rezultat i rritjes së huasë nga 'bankat' dhe 'institucionet financiare jobankare' më shumë se nga rritja e huasë nga burime joformale ('persona fizikë' dhe 'hua në formë malli të papaguar'). Sipas qëllimit të përdorimit, rreth 36% e tepricës së huasë deklarohet për 'blerjen/riparimin e një prone', 36% për 'zhvillimin e një biznesi' dhe vetëm 7% për 'konsum'. Në këtë shpërndarje konstatohet se pesha e tepricës për 'blerje/riparim prone' është rritur në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë.

### ▪ NGARKESA NË BORXH

Shumica e famijeve huamarrëse (81% e familjeve huamarrëse të përgjigjura) deklarojnë që *kësti i huasë* nuk ka ndryshuar gjatë gjashtëmujorit të vrojtuar. *Balanca neto* e përgjigjeve të pjesës tjetër të familjeve huamarrëse (19% e tyre) ka rezultuar 0 pp, si rezultat i peshës së barabartë mes atyre që janë përgjigjur për një ulje të vlerës së këstit dhe atyre që raportojnë rritje të tij. Rreth 68% e familjeve huamarrëse deklarojnë se *aftësia e tyre paguese nuk ka ndryshuar*, ndërsa balanca neto e pjesës tjetër të përgjigjeve tregon *për përmirësim të aftësisë së tyre paguese*, në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2020, rreth 75% e familjeve *nuk presin ndryshim të aftësisë së tyre paguese*, ndërsa balanca neto e pjesës tjetër të të përgjigjurve tregon pritje pesimiste.

### ▪ PASURIA E FAMILJEVE

Rreth 94% e familjeve (totali i kampionit të intervistuar) *zotërojnë 1-2 prona të patundshme*, kryesisht shtëpi banimi dhe kjo peshë ka rënë me 2 pp krahasuar me vrojtimin e kaluar; 2% deklarojnë se zotërojnë *më shumë se 2 prona të patundshme* (shtëpi dhe tokë/dyqan etj.), dhe 4% kanë deklaruar se *nuk zotërojnë asnjë pronë*. Në grupin e familjeve që kanë deklaruar pasuri financiare, rezulton se *depozitat dhe/ose llogaritë bankare* vijnë të mbeten lloji kryesor i investimit financiar, si në rastin e totalit të familjeve (71% e rasteve të raportuara) dhe në rastin e familjeve huamarrëse (85% e rasteve). Këto pesha kanë rezultuar në rritje krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë.


# 1. Karakteristikat demografike dhe financiare të familjeve të intervistuar

**Karakteristikat e kampionit.** Vrojtimi i radhës është kryer mbi kampionin rastësor prej 1210 familjesh, ku rreth 89% e familjeve të kampionit (1074 familje) kanë marrë pjesë në intervistim, duke iu përgjigjur plotësisht ose pjesërisht pyetjeve të pyetësorit. Pësha e të përgjigjurve ndaj totalit të kampionit ka rënë me 1.5 pikë përqindje (pp) krahasuar me vrojtimin e kaluar. Në totalin e familjeve të përgjigjura, rreth 53% banojnë në zona urbane dhe 47% në zona rurale të vendit.

*Analiza në vijim i referohet vetëm familjeve që kanë dhënë përgjigje për secilën pyetje dhe të gjitha llogaritjet janë bërë mbi bazën e totalit të të përgjigjurve.*

**1.1 Punësimi dhe burime të tjera të ardhurash.** Numri total i anëtarëve të familjeve që sigurojnë të ardhura nga punësimi/vetëpunësimi në sektorët shtetëror, privat dhe/ose burime të tjera<sup>1</sup>, ka shënuar rënie si në terma 6-mujorë (me 3.6%) dhe në terma vjetorë (me 7.9%).

**Grafik 1.1 Shpërndarja e personave që sigurojnë të ardhura sipas llojit të burimit**  
(në % ndaj totalit të personave që sigurojnë të ardhura)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim: Zëri 'Tjetër' përmbledh kryesisht rastet e personave që marrin asistencë invaliditeti, ndihmë nga të afërm dhe ata që bëjnë punë të rastit.

Duke e fokusuar analizën vetëm në pjesën e të punësuarve<sup>2</sup> të kampionit të vrojtuar (tabela në vijim), numri total i tyre ka shënuar rënie si krahasuar me 6 muaj më parë (me rreth 6%) dhe krahasuar me një vit më parë (me rreth 10%). Si në terma 6-mujorë dhe në terma vjetorë, rënia e numrit të të punësuarve në kampionin e vrojtuar, ka ardhur nga të tre kategoritë e të punësuarve (sektorët shtetëror, privat dhe të vetëpunësuar).

**Tabelë 1.1 Numri i të punësuarve sipas sektorëve**

		Shtetëror	Privat	Vetëpunësuar	Total të punësuar	Ndr. 6-mujor	Ndr. vjetor
V14	6MI_2017	333 (21%)	575 (36%)	672 (43%)	1580	4.4%	1.7%
V15	6MII_2017	317 (21%)	595 (38%)	634 (41%)	1546	-2.2%	2.1%
V16	6MI_2018	259 (17%)	592(38%)	705 (45%)	1556	0.6%	-1.5%
V17	6MII_2018	280 (18%)	618(39%)	682 (43%)	1580	1.5%	2.2%

<sup>1</sup> Në pyetësor, përveç punësimit në sektorët shtetëror dhe privat, si burime të ardhurash listohen dhe: 'pensioni', 'asistencë sociale për papunësi', 'emigracioni' dhe zëri 'tjetër', ku përfshihet çdo lloj burimi tjetër që nuk është marrë parasysh në alternativat e dhëna.

<sup>2</sup> Këtu janë përfshirë vetëm të punësuarit në sektorët shtetëror, privat (bujqësor dhe jobujqësor) dhe të vetëpunësuar (në sektorët bujqësor dhe jobujqësor).

V18	6MI_2019	266 (18%)	623 (41%)	613 (41%)	1502	-4.9%	-3.5%
V19	6MII_2019	235 (17%)	574 (41%)	606 (43%)	1415	-5.8%	-10.4%


Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Shënim: Shifrat në kllapa janë peshat e secilit zë në raport me totalin e të punësuarve.


Numri i familjeve që kanë deklaruar dhe **burime të tjera të qëndrueshme të ardhurash**<sup>3</sup> ka rezultuar në 9% të të përgjigurve (ose gjithsej 102 familje), duke shënuar rritje me 1 pp gjatë periudhës. Në këtë grup familjesh, rreth 52% e tyre deklarojnë si burime alternative të ardhurash 'interesat nga kursimet (depozita, bono thesari etj.)', 13% deklarojnë të ardhura nga 'qiradhënia e pronave' dhe 30% deklarojnë kombinim burimesh, kryesisht nga qiradhënia dhe interesa nga kursimet.

**1.2 Të ardhurat dhe shpenzimet e familjeve.** Gjatë 6-mujorit në analizë, struktura e shpërndarjes së familjeve sipas nivelit të të ardhurave, ka vijuar të përqendrohet drejt nivelit '17-50 mijë lekë', si në terma 6-mujorë dhe në terma vjetorë, duke rezultuar në 56% të familjeve. Nga ana tjetër, rreth 10% e tyre deklarojnë të ardhura të ulëta mujore 'deri në 17 mijë lekë' (në rënie me 1 pp krahasuar me 6MI-2019), 27% deklarojnë të ardhura mujore '50-100 mijë lekë' dhe 6% deklarojnë të ardhura në nivelin '100-200 mijë lekë'.

**Grafik 1.2 Shpërndarja e familjeve sipas nivelit mujor të të ardhurave**



**Grafik 1.3 Shpërndarja e familjeve sipas nivelit mujor të shpenzimeve**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shpërndarja e familjeve sipas nivelit të shpenzimeve të domosdoshme të jetesës, është zhvendosur disi drejt nivelit mesatar të shpenzimeve mujore. Kështu, rreth 57% e të përgjigurve deklarojnë shpenzime mujore në nivelin '20-50 mijë lekë', dhe kjo peshë është rritur me 6.5 pp krahasuar me 6-mujorin e kaluar, dhe me 4.4 pp krahasuar me një vit më parë. Nga ana tjetër, pesha e familjeve që deklarojnë shpenzime në nivelet e tjera, më të larta apo më të ulëta, ka rezultuar kryesisht në rënie krahasuar me vrojtimin e kaluar.


**Indeksi i të ardhurave**<sup>4</sup> dhe **Indeksi i shpenzimeve**<sup>5</sup> kanë shënuar rënie gjatë periudhës së vroituar, por rënia e indeksit të shpenzimeve ka qenë më e theksuar, duke rezultuar në një *përmirësim të lehtë të balancës financiare (të ardhurave - shpenzime) të familjeve*.

<sup>3</sup> Në këtë pyetje, alternativat e listuara si burime të qëndrueshme të ardhurash janë: (1) qira; (2) interesa nga kursimet (depozita, bono thesari etj.); (3) interesa nga para të dhëna hua të tretëve; (4) tjetër (përcakto).

<sup>4</sup> 'Indeksi i të ardhurave' është ndërtuar si shumë e peshuar e frekuencave në përqindje të përgjigjeve me koeficientet e përcaktuar për çdo interval si në vijim: 'deri në 17 mijë lekë' me 0.2; '17-50 mijë lekë' me 0.4; '50-100 mijë lekë' me 0.6; '100-200 mijë lekë' me 0.8; dhe 'mbi 200 mijë lekë' me 1'. Vlerat e marra për çdo vit janë kthyer në indeks me bazë vitin 2010 = 100. Rritja e vlerës së indeksit nënkupton rritje të nivelit të të ardhurave mujore.

<sup>5</sup> 'Indeksi i shpenzimeve' është ndërtuar si shumë e peshuar e frekuencave në përqindje të përgjigjeve me koeficientet e përcaktuar për çdo interval si në vijim: 'deri në 10 mijë lekë' me 0.2; '10-20 mijë lekë' me 0.4; '20-50 mijë lekë' me 0.6; '50-

**Grafik 1.4** Indekset e të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve  
(2010=100)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 2. Huamarrja e familjeve

Në këtë vrojtim, numri i familjeve që deklarojnë se kanë një ose më shumë hua për të paguar në momentin e intervistimit, pavarësisht llojit, burimit apo vlerës së kësaj huaje, ka rezultuar në 257 familje ose rreth 24% e të përgjigjurve. Kjo peshë ka mbetur e pandryshuar krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe ka shënuar një rënie të lehtë (me 1.8 pp) krahasuar me një vit më parë, duke vijuar të mbetet nën mesataren historike të vrotimit prej rreth 28%.

Analiza në vijim i referohet vetëm grupit të familjeve huamarrëse<sup>6</sup>.


**2.1 Niveli i të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve huamarrëse.** Gjatë 6-mujorit të vrotuar, struktura e shpërndarjes së familjeve huamarrëse sipas të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre duket se është zhvendosur disi drejt një niveli më të lartë të ardhurash mujore (prej '50-100 mijë lekë') dhe një niveli më të lartë shpenzimesh mujore (prej '20-50 mijë lekë'). Konkretisht, shpërndarja e huamarrësve sipas të ardhurave rezulton më e përqendruar në nivelin '17-50 mijë lekë' (54% e huamarrësve), në rënie me 1 pp krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe në nivelin '20-50 mijë lekë' (28% e huamarrësve), në rritje me 5.1 pp gjatë periudhës. Nga ana tjetër, shpërndarja e huamarrësve sipas shpenzimeve (mujore) të domosdoshme të jetesës rezulton më e përqendruar në nivelin '20-50 mijë lekë' në muaj (58% e huamarrësve), në rritje me 5.7 pp krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe në nivelin '100-200 mijë lekë', pothuaj e pandryshuar gjatë periudhës.

Shpërndarja e mësipërme e familjeve huamarrëse sipas nivelit mujor të të ardhurave/shpenzimeve, ka rezultuar në rritje të vlerave të indeksit të të ardhurave dhe rënie të indeksit të shpenzimeve të tyre gjatë periudhës, duke sjellë një përmirësim të balancës financiare (të ardhura-shpenzime).

100 mijë lekë' me 0.8 dhe 'mbi 100 mijë lekë' me 1. Vlerat e marra për çdo vit janë kthyer në indeks me bazë vitin 2010 =100. Rritja e vlerës së indeksit nënkupton rritje të nivelit të shpenzimeve të domosdoshme mujore.

<sup>6</sup> Shënim metodologjik: meqë një familje mund të ketë më shumë se një hua për të paguar në periudhën referuese me karakteristika të ndryshme (burimi, qëllimi etj), për të mos humbur informacionin, në këtë rubrikë, llogaritjet janë bërë mbi 'totalin e rasteve të huamarrjes' të deklaruara, përveçse kur specifikohet '...mbi totalin e huamarrësve (në këtë vrotim = 257 familje). Me 'raste huamarrjeje' nënkuptojmë totalin e huave të marra nga e njëjta familje dhe më të njëjtën karakteristikë, p.sh.: një familje që deklaron 2 hua të marra nga banka përbën '1 rast huamarrje nga banka' dhe një familje që ka një hua nga banka dhe një nga një person fizik, përbën '1 rast huamarrje nga banka' dhe '1 rast huamarrje nga persona fizikë'.


**Grafik 2.1 Indeksi i të ardhurave dhe shpenzimeve të familjes huamarrëse (2010 = 100)**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**2.2 Qëllimet e huamarrjes.** Qëllimet kryesore të huamarrjes mbeten: ‘për konsum’ në 34% të rasteve të huamarrjes, ‘për blerje/riparim i një prone’ në 30% të rasteve dhe për ‘zhvillim biznesi’ në 12% të rasteve. Peshat e rasteve të huamarrjes për ‘blerje/riparim prone’ ka rezultuar në rritje me 2 pp gjatë gjashtëmujorit të vrojtuar dhe në rritje me 4 pp krahasuar me një vit më parë. Nga ana tjetër, huamarrja për ‘konsum’ ka shënuar një rritje të lehtë (me 1 pp) në terma 6-mujorë, por ka shënuar rënie (me 4 pp) në terma vjetorë. Huamarrja për ‘zhvillim biznesi’ ka rezultuar në rënie gjatë të dyja periudhave.

**Grafik 2.2 Huamarrja sipas QËLLIMIT të përdorimit të huasë (në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**2.3 Teprica e huasë.** Duke e analizuar tepricën e deklaruar sipas burimeve rezultoi se për 6-mujorin në analizë, rreth 73% e saj vjen nga burime formale (67.8% nga bankat dhe 5% nga institucione financiare jobanka) dhe rreth 27% nga burime joformale. Kjo strukturë është zhvendosur me 3 pp në favor të huamarrjes nga burime formale krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe me një vit më parë. Kjo ka ardhur si rezultat i rritjes së tepricës së huasë nga ‘bankat’ dhe ‘institucionet financiare jobankare’ më shumë se nga rritja e tepricës së huasë nga burime joformale (‘persona fizikë’ dhe ‘hua në formë malli’). Duke e analizuar tepricën e huamarrjes sipas qëllimit të përdorimit, rezultoi se rreth 39% e saj është përdorur për ‘blerjen/riparimin e një prone’, 36% për


'zhvillimin e një biznesi' dhe 7% është përdorur me qëllime 'konsumi', ku konstatohet se pesha e huamarrjes për 'blerje/riparim prone' është rritur gjatë gjashtëmujorit të vrojtuar dhe krahasuar me një vit më parë (me 2 pp krahasuar me 6MI-2019 dhe me 12 pp krahasuar me 6MI-2018). Kjo prirje është vënë re në tre 6-mujorët e fundit. Nga ana tjetër, pesha e tepicës për 'zhvillim biznesi' ka shënuar gjithashtu rritje (me 5 pp) në terma 6-mujorë, por rënie (me 8 pp) në terma vjetorë.

**Grafik 2.3 Përbërja e tepicës sipas BURIMIT të huasë (në % ndaj totalit të tepicës së deklaruar)**



Burimi: Banka e Shqipërisë.


**Grafik 2.4 Përbërja e tepicës sipas QËLLIMIT të huasë (në % ndaj totalit të tepicës së deklaruar)**



Shënim. Zëri "Të tjera" përfshin kryesisht huamarrje për të përballuar shpenzime mjekësore.

**2.4 Format e huamarrjes.** Në rreth 35% të rasteve të raportuara, huamarrja e familjeve rezultojnë në formën e 'kredisë nga institucione financiare', ku 30% e rasteve janë në trajtë 'kredie bankare' dhe 5% janë në trajtë 'kartash krediti dhe overdraft'. Kjo peshë ka rënë me 2 pp krahasuar me 6-mujorin e kaluar, por ka shënuar rritje me 4 pp krahasuar me një vit më parë. Në rreth 43% të rasteve, huamarrja deklarohet në formën e 'parasë në dorë', duke mbetur e pandryshuar krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe në rënie me 1 pp krahasuar me një vit më parë. Peshë të konsiderueshme vijon të ketë zëri 'mall i papaguar' (21% e rasteve të huamarrjes), në rritje me 2 pp krahasuar me vrojtimin e kaluar, por e pandryshuar krahasuar me një vit më parë.

**Grafik 2.5. Huamarrja sipas FORMËS së huasë (në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)**




Burimi: Banka e Shqipërisë.



**2.6 Pagesa e huasë.** Dy format kryesore të pagesës së huasë vijojnë të mbeten pagesat ‘me shumë të njëjtë çdo 1/3/6/12 muaj’ (51% e rasteve të huamarrjes) dhe ‘me shumë të ndryshueshme në periudha të ndryshme’ (9% e rasteve të huamarrjes). Prirja e peshës së huamarrjes për këto dy forma pagese ka qenë e kundërt gjatë gjashtëmujorit të vrojtuar, ku në rastin e parë pesha është rritur me 22 pp dhe 8 pp, përkatësisht në terma 6-mujorë dhe vjetorë, ndërsa në rastin e dytë pesha ka rënë me 22 pp dhe 5 pp në terma 6-mujorë dhe vjetorë.

**Grafik 2.6 Huamarrja sipas MËNYRAVE TË PAGESËS**

(në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përsa i përket ngarkesës së huasë në të ardhurat e familjeve huamarrëse, rreth 63% e tyre deklarojnë se pagesa e huasë zë më pak se 30% të të ardhurave mujore (‘deri në 10% të të ardhurave’ për 34% të familjeve huamarrëse, ‘10-30% të të ardhurave’ për 29% të familjeve). Nga ana tjetër, rreth 37% të familjeve deklarojnë se kjo pagesë i tejkalon 30% të të ardhurave (‘31-50% të të ardhurave’ për 18% të familjeve dhe ‘51-70’ për 7% të familjeve dhe ‘mbi 70%’ për 13% të familjeve). Në përgjithësi, gjatë dy viteve të fundit (katër vrojtimit e fundit), vihet re një prirje e kësaj shpërndarje për t’u zhvendosur drejt raporteve më të larta kështu të ardhura.

**Grafik 2.7 Huamarrja sipas raportit ‘kësti i huasë/të ardhurat totale mujore’**

(në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**2.7 Afati i mbetur deri në maturim.** Në 63% të rasteve të huamarrjes deklarohet se huaja maturohet ‘brenda një viti’ dhe kjo peshë është rritur me 10 pp krahasuar me 6-mujorin e kaluar; në 32% të rasteve, afati i mbetur

është '1-5 vjet' dhe në 5% të rasteve ka rezultuar 'mbi 5 vjet' (e pandryshuar krahasuar me 6MI-2019, por në rritje krahasuar me një vit më parë).


**Grafik 2.8 Huamarrja sipas MATURIMIT TË MBETUR të huasë**  
(në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**2.8 Garantimi i huamarrjes.** Në 70% të rasteve të huamarrjes rezulton se huaja është 'e pagarrantuar' dhe kjo peshë është rritur me rreth 3 pp krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe me 5 pp krahasuar me një vit më parë. Priorja e kundërt vihet re në ecurinë e rasteve të huamarrjes së garantuar 'me një pronë të familjes'- në rënie në terma 6-mujorë (me 1 pp) dhe në terma vjetorë (me 3 pp).

**Grafik 2.9 Huamarrja sipas FORMAVE TË GARANTIMIT të huasë**  
(në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Shënim: Zëri "tjetër" përmbledh rastet e huamarrjes së garantuar me forma të tjera, ku më shpesh përmendet garantimi i huasë përmes pagës, garantimi me një mall (si makina) etj.

### 3. Ngarkesa në borxh e familjeve

Në këtë seksion pyetjesh, familjeve huamarrëse u kërkohet të japin informacion vetëm për *huanë më të madhe* ekzistuese dhe që rëndon më shumë mbi ekonominë e familjes. Si rrjedhojë, peshat e përgjigjeve janë llogaritur mbi totalin e familjeve huamarrëse të përgjigjura për secilën pyetje.

**3.1 Ndryshimi i këstit.** Rreth 81% e familjeve huamarrëse të përgjigjura kanë deklaruar se kësti i huasë ka mbetur i pandryshuar gjatë 6-mujorit referues. *Balanca neto* e përgjigjeve të pjesës tjetër të familjeve huamarrëse (19% e tyre) ka rezultuar 0 pp, si rezultat i peshës së barabartë mes atyre që janë përgjigjur për një ulje të vlerës së këstit dhe atyre që raportojnë rritje të tij.


**Grafik 3.1 Ndryshimi i këstit mujor të huasë në 6 muajt e kaluar**



Burimi: Banka e Shqipërisë.


**3.2 Aftësia paguese në 6 muajt e kaluar dhe pritshmëritë për 6 muajt e ardhshëm.** Rreth 68% e familjeve huamarrëse kanë deklaruar se aftësia e tyre paguese 'nuk ka ndryshuar' gjatë 6-mujorit të dytë 2019 dhe kjo peshë është rritur me 7 pp krahasuar me 6-mujorin paraardhës. Pjesa tjetër e të përgjigjurve, vlerësojnë në agregat *përmirësim të aftësisë së tyre paguese*, si në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar dhe në krahasim me një vit më parë.

**Grafik 3.2 Aftësia paguese në 6 muajt e kaluar**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Grafik 3.3 Pritshmëritë për aftësinë paguese në 6 muajt e ardhshëm**



Për 6-mujorin e parë të vitit 2020, rreth 75% e familjeve huamarrëse nuk presin ndryshim të aftësisë së tyre paguese (në rënie me 3 pp krahasuar me vrojtimin e kaluar), ndërsa balanca neto e përgjigjeve të pjesës tjetër ka rezultuar -7.4 pp, çka tregon se familjet presin *përkeqësim të aftësisë së tyre paguese në 6 muajt e ardhshëm* dhe kjo prireje ka ardhur duke u theksuar në dy vitet të fundit.

**3.3 Pritshmëritë mbi marrjen e një huaje të re në 6 muajt e ardhshëm**<sup>7</sup>. Rreth 60% e të përgjigurve kanë deklaruar se 'nuk presin të marrin hua të re në 6 muajt e ardhshëm', dhe kjo peshë ka rënë krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë (respektivisht me 7.3 pp dhe 2.9 pp). Nga ana tjetër, rreth 40% e të përgjigurve (ose 432 familje) deklarojnë se e konsiderojnë në shkallë të ndryshme sigurie<sup>8</sup> mundësinë për të marrë/rimarrë një hua të re në 6 muajt e ardhshëm dhe kjo peshë është rritur me 7.3 pp krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe me 2.9 pp krahasuar me një vit më parë.

Si rezultat, *indeksi i mundësisë për të rimarrë një hua të re*<sup>9</sup> ka rezultuar 0.173, duke shënuar rritje krahasuar me vrotimin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë, si dhe duke tejkaluar vlerën e mesatares afatgjatë të tij (Grafik 3.4). Kjo ecuri sinjalizon për një kërkesë të rigjallëruar të familjeve për huamarrje gjatë vitit 2020.


Duke analizuar vetëm grupin e familjeve që *planifikojnë të marrin një hua të re (432 familje)*, rezulton se rreth 63% e tyre janë 'huamarrës të rinj', pra që nuk kanë hua të papaguar në momentin e intervistimit dhe kjo peshë është rritur me 4 pp si në terma 6-mujorë dhe në terma vjetorë, duke konfirmuar rezultatin e mësipërm mbi mundësinë e rritjes së kërkesës për huamarrje nga individët (Grafik 3.5).

**Grafik 3.4** Indeksi i planifikimit të marrjes së një huaje në 6 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Grafik 3.5** Familjet që planifikojnë të marrin hua në 6 muajt e ardhshëm



## 4. Pasuria e familjeve

Kjo rubrikë përmban vetëm 2 pyetje mbi pronat e patundshme dhe pasurinë financiare të familjeve të intervistuar dhe i drejtohet të gjithë kampionit të familjeve. Rezultatet për 6-mujorin e dytë të vitit 2019, paraqiten si më poshtë.

**4.1 Pasuritë e patundshme të familjeve.** Për këtë seksion pyetjesh kanë dhënë përgjigje 1074 familje, nga të cilat 96% kanë deklaruar se zotërojnë të paktën një pronë të patundshme. Familjet e përgjigjura deklarojnë se zotërojnë në total 1536 prona të patundshme të llojeve të ndryshme ku: 94% e tyre (1000 familje) zotërojnë '1-2 prona të patundshme' kryesisht 'shtëpi banimi' ose kombinim i një shtëpie banimi dhe një prone tjetër si


<sup>7</sup> Pyetja i drejtohet të gjithë kampionit prej 1210 familjesh dhe asaj i janë përgjigjur 1074 familje ose rreth 89% e totalit të kampionit.

<sup>8</sup> Alternativat e dhëna janë: 'ka pak mundësi', 'ka shumë mundësi' dhe 'është e sigurt'.


<sup>9</sup> Indeksi është llogaritur si mesatare e peshuar e përqindjes së përgjigjeve për secilën alternativë me koeficientët përkatës. Për përcaktimin e koeficientëve, intervali 0-1 është ndarë në 4 nënintervale me gjatësi të barabartë 0.33. Koeficientët për secilën alternativë rezultojnë: 0 ('nuk ka asnjë mundësi'), 0.33 ('ka pak mundësi'), 0.66 ('ka shumë mundësi') dhe 1 ('është e sigurt'). Indeksi i përfituar merr vlera nga 0 në 1, ku sa më afër 0 të rezultojë vlera e indeksit, aq më e vogël është mundësia për të marrë hua të re dhe, sa më afër 1-shit, aq më e lartë mundësia për të marrë hua të re në 6 muajt e ardhshëm.

'tokë', 'dyqan', 'godinë' etj. Kjo peshë ka rënë krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë, respektivisht me 4 pp dhe 1 pp.

**Grafik 4.1 Shpërndarja e familjeve (total kampioni) sipas numrit të pronave që zotërojnë (në % ndaj totalit të familjeve të përgjigjura)**



**Grafik 4.2 Shpërndarja e familjeve huamarrëse sipas numrit të pronave që zotërojnë (në % ndaj totalit të familjeve të përgjigjura)**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Duke e fokusuar analizën vetëm në grupin e **familjeve huamarrëse** (gjithsej 257 familje), rezulton se familjet e përgjigjura (253 familje) deklarojnë gjithsej 371 prona të patundshme, ku 65% e tyre janë 'shtëpi', 30% janë 'toka' dhe pjesa tjetër janë 'dyqane' dhe 'godina' dhe lloje të tjera pronash.

Në shpërndarjen e familjeve huamarrëse sipas numrit të pronave që zotërojnë rezulton se: rreth 92% e tyre (233 familje) zotërojnë '1-2 prona të patundshme' në momentin e intervistimit, dhe kjo peshë ka rënë me 4 pp krahasuar me vrojtimin e kaluar dhe me 2 pp krahasuar me një vit më parë. Në shumicën e rasteve, këto prona janë një shtëpi banimi ose kombinimi i një shtëpie dhe një sipërfaqeje toke. Vetëm 8% e familjeve huamarrëse (20 familje) deklarojnë se zotërojnë 'më shumë se dy prona' dhe kjo peshë është rritur me 3 pp krahasuar me vrojtimin e 6-mujorit të kaluar.


**4.2 Pasuritë financiare të familjeve**<sup>10</sup>. Nga përgjigjet e dhëna rezultojnë se për periudhën e vërtetuar, 24% e totalit të familjeve të kampionit (huamarrëse dhe johuamarrëse) dhe 43% e grupit të familjeve huamarrëse, deklarojnë se 'nuk zotërojnë asnjë lloj pasurie financiare' dhe të dyja këto pesha kanë rënë respektivisht me 22 pp dhe 9 pp krahasuar me vrojtimin e kaluar.

Nga analiza vetëm e pjesës së familjeve që kanë deklaruar pasuri financiare të formave të ndryshme (duke përjashtuar rastet që 'nuk kanë asnjë lloj pasurie financiare'), rezulton se 'depozitat dhe/ose llogaritë bankare' mbeten lloji kryesor i investimit financiar, si në rastin e totalit të kampionit të familjeve (71% e rasteve të raportuara) dhe në rastin e familjeve huamarrëse (85% e rasteve). Këto pesha kanë rezultuar në rritje krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe me një vit më parë (respektivisht me 4pp dhe 5pp krahasuar me 6MI-2019 dhe me 7pp dhe 9pp krahasuar me 6MII-2018). Nga ana tjetër, përdorimi i formave të tjera të investimit të pasurisë financiare, të përmbledhura në termin "investime të tjera"<sup>11</sup>, ka rezultuar në rënie krahasuar me vrojtimin e kaluar si në rastin e totalit të kampionit të vërtetuar dhe në rastin e grupit të familjeve huamarrëse.


<sup>10</sup> Pyetjes mbi pasuritë e financiare në pronësi të familjeve të intervistuar i janë përgjigjur 1067 familje.

<sup>11</sup> Në zërin "Investime të tjera" përmbledhen rastet e investimeve në: bono thesari, sigurim jete, fond pensioni privat dhe aksione.

**Grafik 4.3 Shpërndarja e familjeve (total kampioni) sipas llojit të pasurisë financiare (në % ndaj totalit të rasteve të deklaruara)**



**Grafik 4.4 Shpërndarja e familjeve huamarrëse sipas llojit të pasurisë financiare (në % ndaj totalit të rasteve të deklaruara)**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në përgjithësi, pesha e rasteve të mbajtjes së pasurisë financiare *brenda sistemit* (ku përfshihen depozita/llogari bankare dhe investime të tjera) ka rezultuar në rritje në dy gjashtëmujorët e fundit kundrejt peshës së rasteve të pasurisë së mbajtur *jashtë sistemit* (ku përfshihen kursime në para të mbajtura jashtë banke ose të dhëna hua). Kjo prirej vihet re si në rastin e totalit të kampionit të familjeve dhe në rastin e grupit të familjeve huamarrëse.